




---

**RAPORTI I TRETË NGA MONITORIMI I  
INFORMIMIT MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDIT**

---



**KUVENDI NËN THJERRËZ**

**Përforcimi i debatit politik  
dhe diskursit deliberativ**

**TETOR 2014**



## **RAPORTI TRETË NGA MONITORIMI I RAPORTIMI MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDIT**

**(NËNTOR 2014)**

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik. Para jush është raporti i dytë i cili ka të bëjë me raportimin e 10 medieve kombëtare në periudhën nga 1 – 30 nëntor i vitit 2014.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike të arrihet në njohuri se në çfarë masë janë mediet pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht në çfarë masë opinionit më të gjerë ja transmetojnë argumentet e prezantuara në diskutimet kuvendore.

Pas çdo muaji të monitoruar opinionit do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe të monitorimit të medieve edhe nga debati në Kuvendin.

### **A. REZYME**

Gjetjet kyçe në raportin e tretë nga monitorimi i informimit mediatik janë se në periudhën e monitoruar, nga 1 deri më 30 nëntor, mediet më së shumti kanë botuar informacione në të cilat si burime janë konsultuar deputetë nga vetëm një opsion politik. Me këtë rast, si burime diç më tepër janë përfaqësuar deputetë aktiv dhe të zgjedhur nga opozita të cilët nuk e pranuan mandatin sesa deputetët e shumicës. Përqindja e informacioneve në të cilat në të njëjtën kohë janë të përfaqësuar burime edhe nga pushteti edhe nga opozita është zvogëluar për gjysmë krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara.

Në nëntor gazetatat dhe televizionet e vëzhguara në mënyrë dominuese e kanë përmendur Kuvendin në kontekst të ngjarjeve më të gjera politike, bojkoti i opozitës të udhëhequr nga LSDM dhe procedura për marrje të mandateve të deputetëve të zgjedhur opozitar. Me këtë, opinionin në pjesë shumë të vogël është i informuar për pjesën më të madhe nga ngjarjet në Kuvendin e që kanë të bëjnë me temat të cilat i shqyrtojnë deputetët dhe argumentet të cilat shpreheshin në favor ose kundër zgjidhjeve ligjore.

Si burim të informacioneve, në lidhje me Kuvendin, më shpesh paraqiten deputetë, por vërehet se numri më i madh i tyre është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme është zvogëluar/shtator dhe tetor). Në



Ilogari të kësaj është rritur përfaqësimi i burimeve nga pushteti ekzekutiv si dhe të përfaqësuesve të jashtëm të cilët kanë komentuar në lidhje me Kuvendin. Gazetat ka shpalosur shumë më tepër informacione në të cilat përmendet Kuvendi në krahasim me televizionet.

## B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

### **Gazeta**

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Večer
- Sloboden pečat
- Koha
- Lajm

### **Televizione**

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediet e përmendura përcillen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët dhe procedura ligjvënëse. Me këtë rast, në hulumtimin, si pjesëtarë të opozitës janë llogaritur edhe pjesëtarët e partive opozitare të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare morën mandate, por vendosën të mos i pranojnë. Në çdo tekst veç e veç dhe në çdo kontribut televiziv analizohen elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji, numri, pala dhe sheshtësia e burimeve.

## V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën dhe Kodin zgjedhor, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Njëqind e njëzet deputetë zgjedhen në lista proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh, ndërsa tre deputetë zgjedhen nga tre njësi zgjedhore në botën e jashtme. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e formon qeverinë, BDI fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë Opsioni qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja




demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i GROM është pjesë e koalicionit në pushtet, ndërsa deputeti i cili mandatin e morri nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin ju bashkëngjit grupit të deputetëve të BDI. Me këtë tani grupi i deputetëve të BDI numëron 20 deputetë.

Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e këtij raporti, deputetët nga koalicioni më i madh të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotuan punën e Kuvendit<sup>1</sup>. Në muajin nëntor në Kuvendin si opozitarë vepronin tre deputetët nga koalicioni i LSDM të cilët vendosën ti pranojnë mandatet. Si opozitarë veprojnë edhe shtatë deputetë të Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH). Shumica në Kuvendin e filloi procedurën për marrje të mandateve të 31 deputeti opozitar të cilët e bojkotuan parlamentin. Procedura vazhdoi edhe në muajin dhjetor.

## G. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport i përfshin informacionet e transmetuara gazetareske që kanë të bëjnë ose që e prekin punën e Kuvendit në periudhën nga 1 deri më 30 nëntor. Gjithsej janë analizuar 116 tekste gazetareske dhe kontribute të botuara në gazetatat dhe në televizionet Nga ato sipas:

- Llojit të medias: 71 % janë në gazeta, ndërsa 29% në televizione
- gjuhës: 72% janë të botuara në mediet në maqedonisht, ndërsa 28% në gjuhën shqipe
- nga tekstet e botuara në mediet e shtypura, 78% janë të botuara në gazetatat në maqedonisht, ndërsa 22% në gazetatat në gjuhën shqipe
- nga kontributet në televizionet, 56% janë të transmetuara në maqedonisht, ndërsa 44% në gjuhën shqipe.




<sup>1</sup> Deputetët opozitarë Roza Topuzovska Karevska nga Partia Liberale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.



## I. ZHANRI I INFORMACIONEVE

Informacionet gazetareske sipas karakteristikave të zhanreve në pjesën më të madhe, 48%, kanë qenë të strukturuar si raporte, përkatësisht vetëm informojnë për ngjarjet e ndërlidhura me Kuvendin. Kjo është ngjashëm në raport me tetorin, por për 13% nga periudha e parë e monitoruar (19 qershor/30 shtator). Nga tekstet dhe kontributet e monitoruara, 25% janë shkrime, përkatësisht kanë elemente informative dhe analitike gjatë raportimit për ngjarjen gjë e cila është për 5% më tepër sesa në muajin tetor dhe 7% më tepër se sa në qershor/shtator. Nga informacionet e botuara 21% janë lajme themelore në të cilat ka vetëm informacion të shkurtër nga ngjarjet e botuara 21% janë lajme themelore në të cilat ka vetëm informacion të shkurtër nga ngjarja dhe 4% janë analiza dhe komente për ngjarje të caktuara.



## II. FOKUSI I TEKSTEVE DHE TË KONTRIBUTEVE


Monitorimi i përmbajtjeve të botuara në mediet tregon se në nëntor është zvogëluar numri i informacioneve në të cilat Kuvendi vetëm përmendet, por informacioni në mënyrë thelbësore nuk ka të bëjë me punën e deputetëve (për 15% krahasuar me tetorin edhe për 9% krahasuar me periudhën qershor/shtator). Nga ana tjetër, ndërkaq, deri tani janë botuar më tepër informacione të cilat kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e Kuvendit dhe në raportet në të. Përqindja e informacioneve të tilla janë 39% krahasuar me 31% në tetor dhe 15% në periudhën qershor/shtator.

Mediet e monitoruara në nëntor në 19% nga përmbajtjet e publikuara kanë informuar për debatet kuvendore në seancat plenare ose në ato të komisioneve gjë e cila është për 8% më tepër se sa në tetor, por për 9% më pak se sa në periudhën qershor/shtator. Në nëntor mediet kanë publikuar më shumë informacione në të cilat informohet për hyrjen në fuqi të ligjit të ri ose të ndryshimeve të ligjeve dhe dispozitave ekzistuese krahasuar me periudhat e kaluara.


Të dhënat nga analiza vënë në pah se edhe në nëntor njëlloj si në tetor Kuvendi më shpesh në kontekst të ngjarjeve aktuale midis partive më të mëdha politike në vendin, më saktë, në kontekst të bojkotit



të opozitës dhe vazhdimi i procedurës për marrje të mandateve të deputetëve të zgjedhur nga opozita të cilët nuk i kanë pranuar mandatet. Rritja e informacioneve nga seancat kuvendore, ndërkaq, në masë të madhe ka të bëjë me interesimin mediatic për diskutimin gjatë procedurës për marrje të mandateve të deputetëve të zgjedhur opozitar në Komisionin për çështje të rregullores dhe çështje të mandatit dhe të imunitetit.





Me këtë rast, mund të vërehet se mediet në gjuhën maqedonase në këtë periudhë shumë më tepër kanë publikuar informacione në të cilat Kuvendi vetëm është përmendur, ose informacionet të cilat kanë qenë në lidhje me punën e përgjithshme me punën e shtëpisë ligjvënëse. Mediet në gjuhën shqipe, ndërkaq, më shpesh kanë publikuar informacione të cilat kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja ose të ndryshimeve të ligjeve.



### III. NUMRI DHE PALA E BURIMEVE


Në tekstet dhe kontributet e monitoruara në nëntor, pjesa më e madhe e informacioneve 40% kanë qenë vetëm me një burim. Kjo është për 6% më pak se sa në tetor, ndërsa për 4% më tepër se sa në periudhën 19 qershor -30 shtator. Me dy burime kanë qenë 25% nga publikimet, ndërsa me tre burime 15% nga informacionet. Monitorimi në nëntor treguan se për 5% është rritur përqindja e informacioneve në të cilat janë theksuar më tepër se tre burime. Në 10% nga përmbajtjet e publikuara në të cilat është përmendur Kuvendi nuk janë theksuar burime.






Për dallim nga periudha e monitoruara paraprakisht kur burime më të shpeshta në informacionet të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin ishin deputetët, në nëntor, ata janë pothuajse të barazuar me burimet e pushtetit ekzekutiv. Në 23% të rasteve burime të informacioneve janë deputetë, ndërsa në 22% anëtarë të Qeverisë. Kjo paraqet zvogëlim për 27% të burimeve – deputetë dhe rritje për 22% të burimeve – pjesëtarë të qeverisë krahasuar me tetorin. Në vendin e tretë si burime janë theksuar burime nga parti politike, përkatësisht anëtarë të partive të cilët nuk janë deputetët të zgjedhur në Kuvendin. Te kjo kategori në raport me periudhën paraprakisht të monitoruar ka zvogëlim prej 14%.

Në nëntor më shpesh si burim i informacioneve janë theksuar përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore krahasuar me dy periudhat paraprakisht të monitoruara (19 qershor - 30 shtator dhe tetor). Gjithashtu, në muajin e fundit paraqiten edhe burime “të tjera”, përkatësisht 11% për dallim prej 4% në tetor dhe 5% në periudhën 19 qershor – 30 shtator. Në këtë kategori më shpesh hyjnë përfaqësues të huaj, ambasadorë, përfaqësues së organizatave ndërkombëtare, ose parlamentarë nga shtete të tjera të cilët kanë pasur komente në lidhje me punën ose raportet në Kuvendin.




Deputetët me emër dhe mbiemër si burime të informacioneve janë vënë në pah në 30% nga përmbajtjet e publikuara në mediet të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin. Kjo është përqindja më e ulët deri tani krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara. Kjo përqindje në tetor ka qenë 57, ndërsa në periudhën 19 qershor – 30 shtator 60%. Në 2% të informacioneve është theksuar se burimet janë deputetë, por identiteti i tyre nuk është publikuar.








Nëse analizohet sipas asaj se cilit opSION politik u takojnë deputetët, të cilët si burim janë konsultuar në tekstet dhe kontributet gazetareske, rezulton se mediet në tetor në 81% të rasteve kanë konsultuar burime të vetëm një pale politike, që është përqindja deri tani më e lartë. Me këtë rast, për dallim nga periudhat paraprakisht të monitoruara (19 qershor - 30 shtator dhe tetor) dallimi midis burimeve nga pushteti dhe opozita është më i vogël. Në nëntor, mediet diç më tepër kanë publikuar informacione në të cilat si burime janë theksuar deputet aktiv ose të zgjedhur nga ana e opozitës të cilët nuk i pranuan mandatet (43%), se sa deputetët nga shumica në pushtet (38%). Në 15% të shkrimeve, përkatësisht më pak deri tani janë konsultuar ose transmetuar qëndrime të deputetëve edhe të pushtetit edhe të opozitës.




#### IV. RUBRIKA

Sipas të dhënave nga monitorimi, 35% të teksteve dhe të kontributeve në të cilat është përfshirë Kuvendi kanë qenë të paralajmëruara në faqet e para të gazetave ose në paralajmërimin e përgjithshëm të lajmeve në ditaret televizive, ndërsa 65% nuk kanë fituar vend të tillë. Në raport me rubrikat, këto informacione më shpesh, në 97% të rasteve janë publikuar në faqet fillestare të gazetave dhe pjesët fillestare të ditareve si “Makedonija”, “Politika”, “Aktuale” ose ngjashëm Informacionet që kanë të bëjnë me Kuvendin shumë më rrallë, në 1% të rasteve janë publikuar në rubrikat kushtuar ekonomisë dhe biznesit. Në rubrikat të përkushtuara komenteve dhe në kolumnat janë publikuar 3% nga informacionet.





Në përmbajtjet e monitoruara mediatike në tetor, në 70% të teksteve dhe kontributeve është theksuar, ndërsa në 30% nuk është theksuar autori i përmbajtjes së publikuar në të cilën Kuvendi.



#### D. KONKLUSIONE:

- Në periudhën e monitoruar, nga 1 deri 30 nëntor është rritur përqindja e informacioneve në të cilat burimet e cituara janë nga vetëm nga një opsioni politik, ndërsa për më tepër se është përgjysmuar përqindja e informacioneve në të cilat njëkohësisht janë përfshirë burime edhe nga pushteti edhe nga opozita krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara.
- Në përmbajtjet e publikuara në të cilat janë konsultuar burime nga vetëm një opsion politik, si burime diç më tepër paraqiten deputetë ose deputetë të zgjedhur nga opozita të cilët nuk e kanë pranuar mandatin sesa nga partitë në pushtet.
- Mediet në këtë periudhë krahasuar me tetorin dhe periudhën 19 qershor – 30 shtator shumë më rrallë si burime kanë konsultuar deputetë dhe parti politike, ndërsa më shpesh përfaqësues të pushtetit ekzekutiv.
- Mediet në nëntor kushtuan më tepër vëmendje në debatin dhe argumentet e prezantuara në seancat kuvendore krahasuar me muajin paraprak, por në përgjithësi jo mjaftueshëm për ta informuar publikun për ngjarjet në Kuvend, temat dhe argumentet të cilat i prezantojnë deputetët.
- Kuvendi në tetor të vitit 2014 më shpesh është përmendur në kontekst të gjendjes më të gjerë politike në vend, raportet midis partive, bojkotit të opozitës dhe procedurës aktuale për marrje të mandateve.
- Mediet në gjuhën maqedonase më tepër në mënyrë të konsiderueshme kanë raportuar për Kuvendin se sa mediet në gjuhën shqipe. Gazetat njëjloj si në periudhën paraprake shumë më tepër se sa televizionet raportojnë për ngjarjet e ndërlidhura me Kuvendin.
- Mediet në gjuhën maqedonase në këtë periudhë shumë më tepër kanë publikuar informacione në të cilat Kuvendi vetëm përmendet, ose informacione të cilat në përgjithësi kanë pasur të bëjnë me punën e shtëpisë ligjvënëse. Mediet në gjuhën shqipe, ndërkaq, më



---

shpesh kanë publikuar informacione të cilat kishin të bëjnë me hyrjen në fuqi të ligjeve të reja ose të ndryshimeve ligjore.

\*\*\*\*\*

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyre nuk mund të llogaritet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.